REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016 - 68228
**Me date: 25.10.2022**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

# AKTVENDIM

Për caktimin e mbikëqyrësit

1. **Arsim Rexhepaj** , CAKTOHET ORGAN MBIKQYRËS në Marrëveshje Bashkpunimi dhe Bashkëfinancimi ndërmjet " Shoqata Grejkoci " dhe të "Komunës së Suharekës", me qëllim të financimit të projektit të ndërtimit të parkut te Gryka dhe regullimi i liqenit artificial si dhe mbjellja e fidaneve në fshatin Grejkoc.

2. Organi mbikëqyrës ka për detyrë ti kryej punët të informon dhe të përpilon raport me shkrim për punët e kryera sipas Marreveshjesdhe sipas dispozitave ligjore të Aplikueshme në Republikën e Kosovës, dhe akteve tjera nënligjore.

Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

**Kryetari i Komunës**

**Bali MUHARREMAJ**

Tënjoftohen:
- Mbikqyresi
- Arkiva

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016 - 68238
**Me date: 25.10.2022**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 59 dhe 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Nr.05/L-031, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekë0 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008si dhe Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik/A01, nxjerrë këtë:

# V E N D I M

**Shegë Bajraktari Zyrtare e lartë per Arsim** caktohet **Menaxher i** Kontratës:Furnizim me Inventar Zyrtar ,Tavolina Pune dhe Ormana Me nr.të prokurimit : 20-0005-1-1-1.

I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të kontrates dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës.
II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj kontrate, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratës.
III. Plani i Menaxhimit të kontratës është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Kontratë origjinale.
IV. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.
V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Bali MUHARREMAJ**

Kryetar i Komunës

Dërgohet:
- Menaxherit të projektit,
- Arkivi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016-06108
**Me date: 12.10.2022**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

# AUTORIZIM

Autorizohet **Shehide Bytyqi me nr personal 1172438608** si zyrtare certifikuese –alternativ në SIMFK e cila do t'a zevendësoj zyrtarin certifikues Xhavit Fondaj pasi që i njejti shkon në ne pensionim .
Autorizimi nuk mund të shërbejë për qëllime tjera.

Ky autorizim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës

**Bali MUHARREMAJ**

**Të njoftohen:**
-Arkiva
-pala

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016 - 65806
**Me datë: 12.10.2022**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerrë:

## VENDIM

I. **Enver Shabani** – Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës: Projekt me bashkëfinancim – Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në zonat rurale në Komunën e Suharekës – Samadraxhë, Bllacë, Vraniq dhe Mushtisht me numër identifikues: 624-22-7412-5-2-1 & 624-022-086-521.

II. **Visar Kuçi** - Drejtor në Drejtorinë për Urbanizim dhe Planifikim caktohet menaxher i kontratës.

III. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratë;

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Kryetari i Komunës**
**Bali MUHARREMAJ**

**Kopje:**
Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës;
Zyrës së Prokurimit;
Arkivit

12. 10. 2022

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.** 016-65684
**Me datë: 11.10.2022**

Duke u bazuar në nenin 13 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të dates 04.11.2008, neni 44 të LPPA-së Nr-05/L-031, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

I. Shfuqizohet vendimi me numër protokolli 01-Nr. 016-15299, i datës 10.03.2022 mbi transferimin e përkohëshëm për zyrtarin e inspekcionit Z. Agim Demiri.

II. I njejti kthehet në vendin e tij të punës sipas akt emërimit në pozitën zyrtar për çështje juridike në drejtorinë për inspekcion, me koaficient 6.

III. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset zyra e personelit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

## Arsyetim

Duke u mbështetur mbi faktin se i njejti gjatë kohës së vendimit mbi transferimin ka shërbyer për interesin e insititucionit të Komunës së Suharekës, përkatësisht shef i inspekcionit ku në bazë të ligjit mbi zyrtarët publik në bazë të nenit 52 pika 1 dhe pika 1.1, Kryetari i Komunës mori vendim që të transferohet përkohësisht në pozitën e shefit të inspekcionit pasi që kjo pozitë aktualisht është pa udhëheqës për shkak se shefi i deriatëhershëm ka kaluar në kompetenca të AVUK-it andaj pas skadimit të kohës mbi transferin e përkohëshëm kabineti i kryetarit konform kompetencave dhe dispozitave ligjore mbi zyrtarët publik vendosi që i njejti të kthehet në vendin e tij të punës.

Të njoftohen:

Agim Demiri

Arkivi

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA E SUHAREKËS**
**MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA**

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**
**01-Nr.**016-64422
**Me datë: 05.10.2022**

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 dhe në mbështetje të zbatimit të veprimit 3.2 të Planit të Veprimit 2022-2024 të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nr. 27.29 të datës, 14.09.2022, nxjerr këtë:

# VENDIM

**1.** Zyrtar përgjegjës për procesin e barrës administrative në kuadër të Komunës së Suharekës, caktohet Rinor Zyrapi, Zyrtar i Depos në Drejtorinë e Administratës.

**2.** Përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për procesin e barrës administrative, janë:

2.1. Koordinimi i procesit të barrës administrative brenda Komunës;

2.2. Komunikimi, përfaqësimi dhe koordinimi me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për mbarëvajtjen e procesit të barrës administrative, në kuadër të komunës;

2.3. Pjesëmarrja dhe kontrollimi i politikave publike të zhvilluara nga Komuna, në kontekst të procesit të barrës administrative;

**3.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Bali MUHARREMAJ

*Vendimi iu dërgohet:*

1. *Z. Rinor Zyrapi*
2. *Zv. Sekretares së MAPL*
3. *Zyrës për Planifikim Strategjik/ZKM*
4. *Arkivit*